

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA TROPOJË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni Barazisë Gjinore dhe Gjithpërfshirjes Sociale**  
**të Këshillit Bashkiak Tropojë**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

Nr. 02 datë 03.05.2025

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit Planin Social të Bashkisë Tropojë

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Gjithpërfshirjes Sociale Këshillit Bashkiak Tropojë, në mbledhjen e tij të radhës, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Bashkia Tropojë lidhur me miratimin e Planit Social të Bashkisë Tropojë për periudhën përkatëse.

**Baza Ligjore**

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

VKM nr. 710, datë 29.12.2017, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;

Udhëzime dhe akte nënligjore të tjera në fuqi, që rregullojnë planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia e Planit Social**

- Plani Social i Bashkisë Tropojë është një dokument strategjik që përcakton nevojat, prioritetet dhe masat konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale për komunitetin. Ai ka si qëllim:
  - Përmirësimin e cilësisë së jetës së grupeve në nevojë;
  - Rritjen e përfshirjes sociale;
  - Mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, të moshuarve, grave dhe grupeve vulnerabël.

**Diskutimet e Komisionit**

Gjatë shqyrtimit të materialit, anëtarët e Komisionit vlerësuan se Plani Social është në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare për përfshirjen sociale. U theksua rëndësia e organizimit të degjesave publike si dhe zbatimit të masave të planifikuara dhe sigurimi i burimeve financiare e njerëzore për realizimin e tyre.

## **Vendimmarrja**

Pas diskutimeve dhe shqyrtimit të materialit të paraqitur, Komisioni i Barazise Gjinore dhe Gjithpërfshirjes Sociale:

Vlerëson pozitivisht Planin Social të Bashkisë Tropojë;

Propozon miratimin e tij në Këshillin Bashkiak Tropojë;

Rekomandon ndjekjen e zbatimit të masave të planifikuara dhe raportimin periodik para Këshillit Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të Planit.

Tropojë, 03 / 07 / 2025